

V E N D I M
Nr. 602, datë 2.11.2001

**PËR ÇMIMET TAVAN TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
PËRDORUESIT FAMILJARË DHE JOFAMILJARË**

(Ndryshuar me VKM nr. 26, datë 16.1.2003)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.7970, datë 20.7.1995 “Për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrit të Shtetit për Energjetikën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimet tavan të shitjes së energjisë elektrike për përdoruesit familjarë, specialë dhe të tjerë të jenë sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pika 2 e vendimit nr.137, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave, vendimi nr.743, datë 18.12.1995 i Këshillit të Ministrave, vendimi nr.564, datë 23.10.2000 i Këshillit të Ministrave dhe vendimi nr.106, datë 2.3.2001 i Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

3. Ngarkohen Enti Rregullator i Energjisë, KESH sh.a., “Elektriku Elbasan” sh.a., “Elektriku Vlorë” sh.a. dhe “SESA Shkodër” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Tabela e çmimeve tavan të shitjes së energjisë elektrike

(Zëvendësuar me VKM nr. 26, datë 16.1.2003)

<i>Kategoria</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Çmimi në lekë/kWh</i>
	<i>Përdorues familjarë</i>	<i>4.5</i>
	<i>300 kwh e para të muajit</i>	
	<i>Përdorues specialë</i>	
	<i>Furrë buke, prodhim mielli</i>	
	<i>Ujësjiellës, objekte fetare</i>	
	<i>Buxhetore, Hidrovoret</i>	
	<i>Nafta, kromi, bakri</i>	
	<i>Siderurgjia, prodhimi i Çimentos, prodhimi i</i> <i>Plehrave Kimike</i>	
	<i>Përdorues të tjerë</i>	
	<i>Furnizimi nga rrjeti TL (35 dhe 110 kv)</i>	
	<i>Furnizimi nga rrjeti TM (6,10 dhe 20 kv)</i>	
	<i>Furnizimi nga rrjeti TU)</i>	

Shënim: Energjia e përdorur për ambjentet e përbashkëta (Ndriçim shkalle, ashensor, pompë uji) dot ë faturohet me çmim tavan 4.5 lekë/kWh

